



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

**Ministria e Integritimit Evropian
Ministarstvo Evropske Integracije - Ministry of European Integration**

01.11.2018

NJOFTIM PËR ZGJATJE TË AFATIT TË: Thirrjes publike për shprehje të interesit për të qenë pjesë e Komisionit Vlerësues për vlerësimin e Projekt – propozimeve të OJQ-ve për promovimin e procesit të integritimit evropian në Republikën e Kosovës

Ministria e Integritimit Evropian, ka planifikuar që përmes thirrjeve publike të ofrojë mbështetje financiare për implementimin e projekteve të OJQ-ve në fushat që ndërlidhen me promovimin e procesit të integritimit Evropian në Republikën e Kosovës.

Në mbështetje të Rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, në Nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo Komisioni Vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve, të pranuar sipas thirrjeve publike duhet të jenë një përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm dhe një përfaqësues nga OJQ.

Ministria e Integritimit Evropian, fton të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për të qenë pjesë e regjistrimit të ekspertëve të jashtëm, të cilët sipas nevojës së Ministrisë së Integritimit Evropian, do të caktohen në cilësinë e anëtarëve të Komisionit Vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes fondeve publike.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, të cilët kanë përvojë punë që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve themelor (Bachelor);
- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një letër motivimi;
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga Udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar.

Aplikimi mund të bëhet përmes Subvencionet.Mie@rks-gov.net, deri më **06.11.2018**. Aplikimi mund të bëhet edhe në kopje fizike në adresën Ministria e Integritimit Evropian, Sheshi Nëna Terezë, Prishtinë, Kati. IX, Zyra Nr. 903.

Ministria e Integritimit Evropian pasi të vlerësoj aplikacionet, do të formojë regjistrin e ekspertëve të jashtëm, të cilët do të ftohen sipas nevojës në Komisionin Vlerësues të MIE-së për projektet propozimet e OJQ-ve.